



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 27, datë 28.01.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMI PËR OBJEKTIN:
““FLATIRON OF VLORA” ZHVILLIM KOMPLEKS PËR NDËRTIMIN E
AMBJENTEVE TË REJA ME FUNKSION BANIM DHE SHËRBIME PREJ 2, 16, 17, 19,
20 DHE 21 KATESH MBI TOKË DHE 4 KATESH NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË
RRUGËN “DHIMITËR KONOMI”, BASHKIA VLORE

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Kumi Konstruksion” sh.p.k, “Semajo” sh.p.k dhe “Eve Construction” sh.p.k Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: ““Flatiron Of Vlora” Zhvillim kompleks për ndërtimin e ambjenteve të reja me funksion banim dhe shërbime prej 2, 16, 17, 19, 20 dhe 21 katesh mbi tokë dhe 4 katesh nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Dhimitër Konomi”, Bashkia Vlorë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Kumi Konstruksion” sh.p.k, “Semajo” sh.p.k dhe “Eve Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINIËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 31 / 12 / 2025